

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nën par 1 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1185/2013, të datës 14.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, **ndryshohet**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1185/2013, të datës 14.03.2017, përkitazi për vendimin për dënimin, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarit L.B., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nën par 1 lidhur me nenin 23 të KPK, i shqipton dënimin me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

II. Në pjesët tjera, aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1185/2013, të datës 14.03.2017, është shpallur fajtor i akuzuari L.B., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nën par 1 lidhur me nenin 23 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim, nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i lartë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.978/2017, të datës 28.08.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, ka

propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i lartë.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, është e bazuar.

Me qenë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur të akuzuarin L.B., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 nën par 1 lidhur me nenin 23 të KPK, mirëpo të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënimi përkatës ligjor, ngase i njëjti është përsëritës (recidivist) i veprave penale të natyrës së njëjtë, fakt ky i cili vërtetohet nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.2085/2012, i dt.31.01.2013, me të cilin aktgjykim i akuzuari është shpallur fajtor për katër vepra penale të vjedhjes së rëndë, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.317/2013, të dt.12.03.2015, andaj konsiderojmë se dënimi i shqiptuar është shumë i butë në raport me peshën e veprës penale të kryer, përgjegjësinë penale të akuzuarit, natyrën e kësaj vepre penale, dhe se me dënime të tilla nuk do të mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga prokuroria, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes se vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i njëjti ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se është penduar thellësisht për veprën e kryer penale, se është i pa punë, se është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, mirëpo kolegji i kësaj gjykate, pas vlerësimit të ankesës së prokurorisë, ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk është proporcional me peshën e veprës penale të kryer, përgjegjësinë penale të akuzuarit si dhe natyrën e kësaj vepre penale, andaj, duke i vlerësuar këto rrethana, në mbështetje të dispozitave përkatëse ligjore, kolegji i kësaj gjykate duke patur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe rrezikshmërinë shoqërore të saj, vlerëson që aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet sikurse në dispozitiv, duke qenë i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e

veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.961/2017 të datës 27.09.2017

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq